



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 207

Tiranë – E premte, 7 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 5.11.2025	Për lirim nga detyra..... 24703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 5.11.2025	Për emërim në detyrë..... 24703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 5.11.2025	Për lirim nga detyra..... 24703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 5.11.2025	Për emërim në detyrë..... 24703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 5.11.2025	Për lirim dhe emërimin e dy anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës..... 24703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 5.11.2025	Për përcaktimin e kufijve hidrografikë e territorialë të baseneve dhe të rajoneve të baseneve lumore e trupave të tjerë ujorë sipërfaqësorë, ujërave nëntokësore dhe ujërave bregdetare në rajonet individuale të baseneve lumore, qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre, si dhe miratimin e elementeve të informacionit për secilin autoritet kompetent..... 24704
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 637, datë 5.11.2025	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Këshilli i Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të Pronës, me emërtimin “Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, me numër pasurie 6/523 dhe pjesë të pasurisë me numër 6/210, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrit të Drejtësisë së trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar..... 24729

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 5.11.2025	Për autorizimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Kayo” sh.a., që, vetë ose nëpërmjet subjekteve të tjera të krijuara prej saj, të realizojë prodhimin dhe tregtimin e armëve ose të pjesëve të tyre, municioneve, teknologjive, pajisjeve, veshjeve dhe mjeteve, të prodhuara, apo të përshtatura në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo shërbime për t’u përdorur nga strukturat e sigurisë, organet e varësisë së strukturave të sigurisë, apo shoqërive aksionare shtetërore të krijuara nga këto struktura sigurie.....	24731
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 5.11.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 289, datë 17.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (<i>Multinational Force and Observers, MFO</i>), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit”	24732
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 5.11.2025	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Shkodrës	24732
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 5.11.2025	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Gjirokastrës.....	24733
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 23, datë 28.10.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 14.5.2018, “Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit”	24733
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 123, datë 3.11.2025	Për delegimin e kompetencave.....	24734
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1062, datë 28.10.2025	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimit të kompetencave të zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	24734
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1063, datë 28.10.2025	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave për zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	24735
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 1064, datë 28.10.2025	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave për zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	24735

**VENDIM****Nr. 631, datë 5.11.2025****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Sokol Duma, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 632, datë 5.11.2025****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Martin Kajo emërohet zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 633, datë 5.11.2025****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 634, datë 5.11.2025****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Armela Baka emërohet zëvendësministër i Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 635, datë 5.11.2025****PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN
E DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Lirimin e z. Ermal Nufi, anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe emërimin e znj. Viola Haxhiademi anëtar të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Lirimin e z. Alban Mësonjësi, anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe emërimin e z. Dritan Palnikaj anëtar të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 636, datë 5.11.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE
HIDROGRAFIKË E TERRITORIALE TË
BASENEVE DHE TË RAJONEVE TË
BASENEVE LUMORE E TRUPAVE TË
TJERË UJORË SIPËRFAQËSORË,
UJËRAVE NËNTOKËSORE DHE
UJËRAVE BREGDETARE NË RAJONET
INDIVIDUALE TË BASENEVE
LUMORE, QENDRËN E PËRBËRJEN E
KËSHILLIT TË SECILIT PREJ TYRE, SI
DHE MIRATIMIN E ELEMENTEVE TË
INFORMACIONIT PËR SECILIN
AUTORITET KOMPETENT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 1, shkronjat “d”, “dh” e “p”, 13, pika 3, dhe 14, pika 4, të ligjit nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kufijve hidrografikë të baseneve lumore kryesore, të përmendura në nenin 12 të ligjit nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, të ndryshuar, sipas hartës hidrografike të paraqitur në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për qëllime të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, i ndryshuar, në territorin e Republikës së Shqipërisë ngrihen shtatë rajone të baseneve lumore, si më poshtë vijon:

- a) Rajoni i basenit lumor Drin - Bunë;
- b) Rajoni i basenit lumor Mat;
- c) Rajoni i basenit lumor Ishëm;
- ç) Rajoni i basenit lumor Erzen;
- d) Rajoni i basenit lumor Shkumbin;
- dh) Rajoni i basenit lumor Seman;
- e) Rajoni i basenit lumor Vjosë.

3. Kufijtë territorialë të rajoneve të baseneve lumore dhe të baseneve lumore kryesore janë të njëjta, të përcaktuara sipas hartës së paraqitur në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Përcaktimi i ujërave nëntokësore, që bëjnë pjesë në rajonet individuale të baseneve lumore, është sipas hartës së paraqitur në shtojcën III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Përcaktimi i nënbaseneve, që bëjnë pjesë në rajonet e baseneve lumore Mat, Ishëm dhe Erzen, është sipas hartës së paraqitur në shtojcën IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Përcaktimi i ujërave bregdetare, që bëjnë pjesë në rajonet e baseneve lumore Mat, Ishëm dhe Erzen, është sipas hartës së paraqitur në shtojcën V, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Për efekt menaxhimi të burimeve ujore, për çdo rajon të basenit lumor ngrihet dhe funksionon Këshilli i Basenit Lumor (në vijim, KBL), përkatësisht, si më poshtë vijon:

- a) Këshilli i Basenit Lumor Drin–Bunë, me qendër në Shkodër;

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2000, “Për krijimin e një kuadri për veprimin e komunitetit Faqe | 24704

në fushën e politikës së ujërave”, të ndryshuar, numri CELEX 32000L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 327, datë 22.12.2000, faqe 1–73.



b) Këshilli i Basenit Lumor Mat, me qendër në Lezhë;

c) Këshilli i Basenit Lumor Ishëm, me qendër në Durrës;

ç) Këshilli i Basenit Lumor Erzen, me qendër në Tiranë;

d) Këshilli i Basenit Lumor Shkumbin, me qendër në Elbasan;

dh) Këshilli i Basenit Lumor Seman, me qendër në Fier;

e) Këshilli i Basenit Lumor Vjosë, me qendër në Vlorë.

8. Kryetar i KBL-së është prefekti i qarkut, ku ndodhet qendra e Këshillit të Basenit Lumor.

9. FunkSIONET e sekretariatit teknik të KBL-së ushtrohen nga zyra e administrimit të basenit lumor përkatës.

10. Numri i anëtarëve për çdo KBL është, si më poshtë vijon:

a) rajoni i basenit lumor Drin–Bunë	23 anëtarë;
b) rajoni i basenit lumor Mat	19 anëtarë;
c) rajoni i basenit lumor Ishëm	15 anëtarë;
ç) rajoni i basenit lumor Erzen	17 anëtarë;
d) rajoni i basenit lumor Shkumbin	21 anëtarë;
dh) rajoni i basenit lumor Seman	31 anëtarë;
e) rajoni i basenit lumor Vjosë	27 anëtarë.

11. Përbërjet e KBL-ve janë, si më poshtë vijon:

a) KBL Drin-Bunë përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Shkodrës (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Malësi e Madhe	një anëtar;
- Tropojë	një anëtar;
- Shkodër	një anëtar;
- Fushë-Arës	një anëtar;
- Has	një anëtar;
- Vau i Dejës	një anëtar;
- Pukë	një anëtar;
- Kukës	një anëtar;
- Dibër	një anëtar;
- Lezhë	një anëtar;
- Bulqizë	një anëtar;
- Pogradec	një anëtar;
- Pustec	një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtorja Rajonale e Mjedisit	një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura	një anëtar;

- Drejtorja Rajonale e Operatorit të

Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;

- Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar;

- Agjencia Rajonale e Bregdetit Lezhë një anëtar

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;

- furnizimin me ujë një anëtar;

- ujitjen një anëtar;

- hidroenergjinë dhe industrinë një anëtar.

b) KBL Mat përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Lezhës (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Fushë-Arës	një anëtar;
- Pukë	një anëtar;
- Mirditë	një anëtar;
- Lezhë	një anëtar;
- Kurbin	një anëtar;
- Krujë	një anëtar;
- Mat	një anëtar;
- Klos	një anëtar;
- Bulqizë	një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtorja Rajonale e Mjedisit	një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura	një anëtar;
- Drejtorja Rajonale e Operatorit të	
Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor	një anëtar;
- Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit	një anëtar;
- Agjencia Rajonale e Bregdetit Lezhë	një anëtar.

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore	një anëtar;
- furnizimin me ujë	një anëtar;
- ujitjen	një anëtar;
- hidroenergjinë dhe industrinë	një anëtar.

c) KBL Ishëm përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Durrësit (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Durrës	një anëtar;
- Tiranë	një anëtar;
- Krujë	një anëtar;
- Vorë	një anëtar;
- Kamzë	një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:



- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar;
- Agjencia Rajonale e Bregdetit Durrës një anëtar.

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- ujitjen një anëtar;
- hidroenergjinë dhe industrinë një anëtar.

c) KBL Erzen përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Tiranës (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Tiranë një anëtar;
- Vorë një anëtar;
- Durrës një anëtar;
- Kavajë një anëtar;
- Shijak një anëtar;
- Rrogozhinë një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit një anëtar.

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë dy anëtarë;
- ujitjen një anëtar;
- hidroenergjinë dhe industrinë një anëtar.

d) KBL Seman përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Fierit (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Divjakë një anëtar;
- Lushnjë një anëtar;
- Belsh një anëtar;
- Cërrik një anëtar;
- Gramsh një anëtar;
- Kuçovë një anëtar;
- Ura Vajguore një anëtar;

- Roskovec një anëtar;
- Patos një anëtar;
- Fier një anëtar;
- Maliq një anëtar;
- Berat një anëtar;
- Korçë një anëtar;
- Devoll një anëtar;
- Skrapar një anëtar;
- Poliçan një anëtar;
- Kolonjë një anëtar;
- Elbasan një anëtar;
- Mallakastër një anëtar;
- Memaliaj një anëtar;
- Përmet një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale nga:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar;
- Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë një anëtar.

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- ujitjen një anëtar;
- hidroenergjinë dhe industrinë një anëtar.

dh) KBL Shkumbin përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Elbasanit (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Librazhd një anëtar;
- Përrenjas një anëtar;
- Pogradec një anëtar;
- Elbasan një anëtar;
- Kavajë një anëtar;
- Peqin një anëtar;
- Rrogozhinë një anëtar;
- Lushnjë një anëtar;
- Divjakë një anëtar;
- Cërrik një anëtar;
- Belsh një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;



- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit një anëtar.

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- ujitjen një anëtar;
- hidroenergjinë dhe industrinë një anëtar.

e) KBL Vjosë përbëhet nga:

i. prefekti i Qarkut të Vlorës (kryetar);

ii. drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive:

- Fier një anëtar;
- Vlorë një anëtar;
- Mallakastër një anëtar;
- Selenicë një anëtar;
- Memaliaj një anëtar;
- Këlcyrë një anëtar;
- Përmet një anëtar;
- Kolonjë një anëtar;
- Tepelenë një anëtar;
- Gjirokastrë një anëtar;
- Libohovë një anëtar;
- Dropull një anëtar;
- Konispol një anëtar;
- Sarandë një anëtar;
- Finiq një anëtar;
- Delvinë një anëtar;
- Himarë një anëtar.

iii. drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar Vjosë një anëtar;
- Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar;
- Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë një anëtar.

iv. përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- ujitjen një anëtar;
- hidroenergjinë dhe industrinë një anëtar.

12. Drejtuesit e institucioneve lokale emërohen si anëtarë të KBL-së nga kryetari i KBL-së përkatëse, me propozim të titullarit të institucionit përkatës, dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit emërohen si anëtarë të KBL-së nga kryetari i KBL-së përkatëse,

me propozim të zyrës së administrimit të basenit lumor përkatës. Përfaqësuesit e grupit të interesit duhet të jenë punonjës apo anëtarë në organizata apo në shoqata, që kanë për objekt veprimtarie një nga fushat e përcaktuara në pikën 11 të këtij vendimi.

13. Për të gjitha organet kombëtare të administrimit e të menaxhimit të burimeve ujore të përcaktuara në ligjin nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, të ndryshuar, dhe secilin këshill baseni lumor, të identifikuar si autoritet kompetent në nivel rajoni baseni lumor, sipas këtij vendimi, AMBU-ja publikon në faqen e saj zyrtare të dhënat e mëposhtme:

a) Emrin dhe adresën zyrtare të autoritetit kompetent të identifikuar, në përputhje me legjislacionin për burimet ujore;

b) Mbulimin gjeografik të territorit të basenit lumor: emrat e lumenjve kryesorë, së bashku me përshkrimin e territorit të basenit apo të rajonit të basenit lumor. Informacioni duhet të jetë i disponueshëm për përfshirje në sistemin e informacionit gjeografik (GIS) dhe/ose në sistemin e informacionit gjeografik të Komisionit Evropian (GISCO);

c) Statusin ligjor të autoritetit kompetent: përshkrimi i statusit ligjor të autoritetit kompetent dhe, nëse është e përshtatshme, përmbledhja ose kopja e statutit të tij, aktit të themelimit apo e një dokumenti tjetër të përshtatshëm;

ç) Përgjegjësitë: përshkrimi i përgjegjësiave ligjore dhe administrative për çdo autoritet kompetent dhe roli i tij brenda basenit apo rajonit të basenit lumor;

d) Anëtarësinë: kur autoriteti kompetent vepron si organ bashkëkoordinues për autoritetet e tjera kompetente, AMBU-ja vë në dispozicion listën e këtyre organeve së bashku me përmbledhjen e marrëdhënies institucionale të krijuar me qëllim sigurimin e bashkëkoordinimit;

dh) Marrëdhëniet ndërkombëtare: në rastin e baseneve lumore ndërkufitare, AMBU-ja jep edhe një përmbledhje të marrëdhënieve institucionale të krijuara me qëllim sigurimin e koordinimit.

14. AMBU-ja sigurohet që informacioni i kërkuar, në përputhje me pikën 13 të këtij vendimi, të publikohet në faqen e saj të internetit brenda 6 (gjashtë) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. AMBU-ja siguron përditësimin e këtij informacioni në rastet e ndryshimeve.



15. Anëtarët e këshillave të baseneve lumore shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, të bordeve ose të komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore, por jo më shumë se 6 (gjashtë) pagesa në vit.


16. Vendimi nr. 696, datë 30.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së Këshillit të secilit prej tyre”, shfuqizohet.

17. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe autoritetet e tjera kompetente të administrimit e të menaxhimit të burimeve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama


SHTOJCA I HARTA E KUFIJVE HIDROGRAFIKË TË BASENEVE LUMORE KRYESORE








SHTOJCA II


HARTAT E KUFIJVE TERRITORIALE TË RAJONEVE TË BASENEVE LUMORE DHE TË BASENEVE LUMORE KRYESORE























SHTOJCA III
HARTAT E UJËRAVE NËNTOKËSORE, QË BËJNË PJESË NË
RAJONET INDIVIDUALE TË BASENEVE LUMORE



















SHTOJCA IV
HARTAT E NËNBASENEVE, QË BËJNË PJESË NË RAJONET E BASENEVE
LUMORE MAT, ISHËM DHE ERZEN












SHTOJCA V
HARTAT E UJËRAVE BREGDETARE, QË BËJNË PJESË NË RAJONET E BASENEVE
LUMORE MAT, ISHËM DHE ERZEN









VENDIM
Nr. 637, datë 5.11.2025

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË
SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E
DREJTËSISË TEK KËSHILLI I LARTË
GJYQËSOR, PËR GJYKATËN E APELIT
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TË PRONËS, ME EMËRTIMIN “GJYKATA
E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM”, ME NUMËR PASURIE
6/523 DHE PJESË TË PASURISË ME
NUMËR 6/210, NË ZONËN KADASTRALE
8150, TIRANË, SI DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1292,
DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË SË
TROJEVE DHE NDËRTHESAVE TË
GJYKATAVE TË RRETHEVE
GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË
APELIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Këshilli i Lartë

Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të pronës, me emërtimin “Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, me numër pasurie 6/523 dhe pjesë të pasurisë me numër 6/210, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, me qëllim për t’u përdorur për ushtrimin e aktivitetit administrativ, sipas formularit, 1 (një) fletë, dhe planrilevimit, 1 (një) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Prona me emërtimin “Tsh-Gjykata e Apelit Ushtarak, Tiranë” hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë së trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar.


3. Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u ndalohe ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Institucioni: Këshilli i Lartë Gjyqësor Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Fusha e përdorimit të Pronës: Administratë				Identifikoi: Anjeza Bani ; Drejtor Drejtorie (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supervizoi: Lertida Balili, Kancelar (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprovoi: Iliba Bezati , Zëvendëskryetar (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulë)						
Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8150 TR-P-13	6/523	Truall	Gjykata Apelit Juridiksionit te Pergjithshem	328	251.1	Gjykata Apelit Juridiksionit te Pergjithshem	Keshilli i Larte Gjyqesor	Gjykata Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem	Ndertese 3 Kate
2	8150 TR-P-13	Pjese e Pas. 6/210	Truall	Gjykata Apelit Juridiksionit te Pergjithshem	48.18		Gjykata Apelit Juridiksionit te Pergjithshem	Keshilli i Larte Gjyqesor	Gjykata Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem	



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET

DATE : 28/07/2025

QELIMI : INVENTARIZIM / REGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA TIRANE DVASHK/ZVASHK TIRANE VERI

ZONA KADASTRALE 8150

NUMRI PASURISE 6/210 DHE 6/523

INDEX HARTE TR; P-13

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE : TRUALL, RRUGE

SIP.PAS. 6/523 S= 368.14 m2

SIP.PAS. 6/210 S= 1421.5 m2

SIPERFAQE E GJURMES SE NDERTIMIT = 245.87m2

SIPERFAQE E GJURMES SE NDERTIMIT = m2

NUMRI KATEVE

NUMRI PEMEVE


X=485418.8135

Y=4576897.3787

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=485418.8135

Y=4576962.0616



SHPIJEGUES

- PRONA E CILA KERKOHET PER KALIM NE PERGJEGJESI ADMINISTRIM, TRUALL, ME SIPERFAQE SIPAS FAKTIT
S= 376.18m² (S=328m² PAS.6/523+S=48.18m² PAS.6/210)
NGA KJO:
- SIP. E GJURMES SE NDERTES (3KT) SIPAS FAKTIT
S=251.1m²
- PASURIA 6/210 RRUGE SIPAS FAKTIT

X=485516.1829

Y=4576897.3787

SH 1:500

X=485516.1829

Y=4576962.0616

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			PAS. 6/210		
2	LINDJE			PAS. 6/210		
3	JUG			PAS. 6/522		
4	PERENDIM			PAS. 6/522 E 6/210		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: ING. GJEODET LESJAN DOSTI

LICENCA: NR. T.1139/3 DATE 28.03.2025

KOMPANIA: LESJAN DOSTI P.F

NIPT: L82067801R

NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _____

DVASHK _____

NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI

Lesjan

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA _____

Digitally signed by
Lesjan Dosti
Date: 2025.09.02
10:57:38 +0200

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-TERREN , G-GPS, D-MATJE DISTANCASH

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: _____

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI : SHTET

NENSHKRIMI _____



Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

**VENDIM****Nr. 638, datë 5.11.2025**

**PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË
AKSIONARE SHTETËRORE “KAYO”
SHA, QË, VETË OSE NËPËRMJET
SUBJEKTEVE TË TJERA TË KRIJUARA
PREJ SAJ, TË REALIZOJË PRODHIMIN
DHE TREGTIMIN E ARMËVE OSE TË
PJESËVE TË TYRE, MUNICIONEVE,
TEKNOLOGJIVE, PAJISJEVE,
VESHJEVE DHE MJETEVE, TË
PRODHUARA, APO TË PËRSHTATURA
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, APO SHËRBIME PËR T’U
PËRDORUR NGA STRUKTURAT E
SIGURISË, ORGANET E VARËSISË SË
STRUKTURAVE TË SIGURISË, APO
SHOQËRIVE AKSIONARE
SHTETËRORE TË KRIJUARA NGA
KËTO STRUKTURA SIGURIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është:

a) autorizimi i shoqërisë aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. që, vetë ose nëpërmjet subjekteve të tjera të krijuara prej saj, të realizojë prodhimin dhe tregtimin e armëve ose të pjesëve të tyre, municioneve, teknologjive, pajisjeve, veshjeve dhe mjeteve, të prodhuara apo të përshtatura në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo shërbime për t’u përdorur nga strukturat e sigurisë, organet e varësisë së strukturave të sigurisë apo shoqërive aksionare shtetërore të krijuara nga këto struktura sigurie;

b) përcaktimi i rregullave, që zbatohen nga subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, për furnizimin me produkte të prodhuara apo të përshtatura në Republikën e Shqipërisë apo shërbime, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve,

pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, nëpërmjet shoqërisë aksionare shtetërore “KAYO” sh.a., ose subjekteve të tjera të krijuara prej saj.

2. Qëllimi i këtij vendimi është që t’u sigurojë subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, furnizimin me produkte, apo shërbime, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, nëpërmjet shoqërisë aksionare shtetërore “KAYO” sh.a., apo subjekteve të krijuara prej saj.

3. Shoqëria aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. dërgon pranë autoriteteve kërkuese listën e produkteve dhe shërbimeve, që ofron vetë ose nëpërmjet shoqërive të krijuara prej saj, minimalisht çdo 6 (gjashtë) muaj.

4. Të gjitha autoritetet kërkuese, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kanë të nevojshme furnizimin me produkte apo shërbime nga shoqërisë aksionare shtetërore “KAYO” sh.a., detyrimisht i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie për të përfituar produktet apo shërbimet që ofron ajo, bazuar në listën e produkteve dhe shërbimeve që ofron vetë ose nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj.

5. Kërkesa, sipas pikës 4 të këtij vendimi, paraqitet në formë shkresore dhe shoqërohet me projektin për mallrat ose shërbimet e kërkuara. Në projekt përfshihen qëllimi i përdorimit, referencat ligjore, specifikimet teknike të mallrave ose shërbimeve, mënyra e zbatimit dhe vlera e projektit.

6. Shoqëria aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. shprehet për mundësinë e furnizimit, sipas kërkesës së administruar nga autoriteti kërkuës, me produkte apo shërbime nga vetë kjo shoqëri ose shoqëri të krijuara prej saj.

7. Në rastet kur shoqëria aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. shprehet se nuk mund të furnizojë autoritetet kërkuese, në përputhje me specifikimet teknike apo projektin e parashtruar, autoritetet kërkuese vijojnë me realizimin e prokurimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, ose prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

8. Në rastet kur shoqëria aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. nuk shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës lidhur me mundësinë e realizimit të furnizimit, kërkesa konsiderohet e refuzuar dhe autoritetet kërkuese vijojnë me realizimin e prokurimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi



për prokurimin publik ose prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

9. Në rastet kur shoqëria aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. mund të furnizojë autoritetet kërkuese, në përputhje me kërkesën e paraqitur prej tyre, vetë ose nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, autoritetet kërkuese hyjnë në negociata të drejtpërdrejta me këtë shoqëri për plotësimin e nevojave të tyre, në marrëveshje ndërmjet palëve.

10. Ngarkohen shoqëria aksionare shtetërore “KAYO” sh.a. të gjitha strukturat, që operojnë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe organet e tyre të varësisë apo shoqëritë aksionare shtetërore të krijuara prej tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 639, datë 5.11.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI PJESË E FORCËS SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE (*MULTINATIONAL FORCE AND OBSERVERS, MFO*), NË SINAI, REPUBLIKA ARABE E EGJIPTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 289, datë 17.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave

të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (*Multinational Force and Observers, MFO*), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 30.12.2029, me rotacion deri në 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit për në mision.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 641, datë 5.11.2025

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Majlinda Angoni, prefekt i Qarkut të Shkodrës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Holta Duda emërohet prefekt i Qarkut të Shkodrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 642, datë 5.11.2025

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Odise Kote, prefekt i Qarkut të Gjirokastrës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Albana Hasanaj emërohet prefekt i Qarkut të Gjirokastrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 23, datë 28.10.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 14.5.2018,
“PËR FORMATIN E FORMULARIT TË
DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË
TATIMIT MBI LOJËRAT E FATIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 64, pika 4, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 18, datë 14.5.2018, “Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në rubrikën XVI “Kazino/kazino me 5 yje/resort kazino”, në seksionin C.1, në formularin e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit bëhen shtesat dhe ndryshimet:

a) Në rubrikën [95/96], emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë:

“Për tryezat me më shumë se një pozicion ruletë, 25% mbi të ardhurat bruto”;

b) Në rubrikën [97/98], emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë:

“Për tryezat e lojërave me letra dhe/ose me zëre, 25% mbi të ardhurat bruto”;

c) Pas rubrikës [101/102], shtohet rubrika [102.1/102.2], me përmbajtjen si vijon:

[102.1/102.2]	Turnetë e lojërave 25 %	102.1	102.2
	mbi të ardhurat bruto		

2. Në udhëzuesin “Për mënyrën e plotësimit të formularit” bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

a) Në kreun XVI “Kazino/kazino me 5 yje/resort kazino” seksionin C.1 bëhen shtesat dhe ndryshimet:

i. Rubrika [96], ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Norma e taksës në %, e përcaktuar me ligj, shumëzuar me vëllimin e qarkullimit të realizuar për periudhën për të cilën paguhet taksë për tryezat me më shumë se një pozicion, ruletë, rubrika [95] $\times$ 25% mbi të ardhurat bruto”;

ii. Rubrika [98], ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Norma e taksës në %, e përcaktuar me ligj, shumëzuar me vëllimin e qarkullimit të realizuar për periudhën për të cilën paguhet taksë për tryezat e lojërave me letër dhe/ose me zëre, rubrika [97] $\times$ 25% mbi të ardhurat bruto”;

iii. Pas rubrikës [102] shtohet:

- Rubrika [102.1], me përmbajtje si më poshtë:

“Të ardhurat bruto të realizuara për periudhën për të cilën paguhet taksë për turnetë e lojërave”;

- Rubrika [102.2], me përmbajtje si më poshtë:

“Norma e taksës në %, e përcaktuar me ligj, shumëzuar me të ardhurat bruto të realizuara për periudhën për të cilën paguhet taksë për turnetë e lojërave, [102.1] $\times$ 25% mbi të ardhurat bruto”;

b) Në rubrikën [105], në kreun XVII “Kazino elektronike”, seksioni C.1, në shumën e rubrikave tatimi për t’u paguar, pas rubrikës “104” shtohet rubrika “102.2”.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE
Petrit Malaj



URDHËR

Nr. 123, datë 3.11.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”; neneve 22, pikat 3, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it koordinatorit pranë drejtorit të përgjithshëm, znj. Marçela Shahini, për shkak të mungesës me arsye të titullarit.

2. Delegimi i kompetencave përfshin vetëm fushën e veprimtarisë administrative të institucionit.

3. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë do të ushtrohen për periudhën nga data 3.11.2025 deri më datë 7.11.2025.

4. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar, me ndërprerjen vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.

5. Për vendimmarrje të një rëndësie të veçantë, apo çështje të caktuara, znj. Marçela Shahini duhet të marrë miratimin paraprak nga drejtori i përgjithshëm ,nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

6. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, koordinatori pranë drejtorit të përgjithshëm do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara, apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

7. Ngarkohet znj. Marçela Shahini, koordinator pranë drejtorit të përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Linda Pustina

URDHËR

Nr. 1062, datë 28.10.2025

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË DHE DELEGIMIT TË
KOMPETENCAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113; të ligjit nr. 44/2015; “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Znj. Megi Fino, zëvendësministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen, koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të angazhimeve në kuadrin e procesit të integritetit evropian si dhe përgatitjen e raporteve për Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe institucionet e Bashkimit Evropian, në lidhje me këtë proces;

b) Zhvillimin e konsultimeve politike dypalëshe, ku kërkohet nivel zëvendësministri;

c) Përfaqësimi në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare në nivel zëvendësministri;

d) Ndjekjen, koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi çështjet e politikave të sigurisë;

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.



4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 827, datë 22.10.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali

URDHËR
Nr. 1063, datë 28.10.2025

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE PËR
ZËVENDËSMINISTRIN PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Znj. Vilma Premti, zëvendësinistre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen e zbatimit të prioritetëve dhe të objektivave të Shërbimit të Jashtëm, me qëllim energjizimin e strukturave, monitorimin, ndjekjen e politikave dhe praktikave të burimeve njerëzore, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon shërbimin e jashtëm;

b) Ndjekjen dhe mbikëqyrjen e politikave dhe veprimtarisë konsullore, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve ndaj qytetarëve;

c) Ndjekjen e procesit të hartimit dhe të zbatimit të politikave dhe akteve ligjore, në përputhje me prioritetet dhe objektivat e përcaktuar në aktet rregullatore përkatëse;

d) Koordinimin dhe ndjekjen e procesit të hartimit të akteve dhe procedurave administrative të brendshme, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në praktikë;

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 923, datë 28.10.2024. “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali

URDHËR
Nr. 1064, datë 28.10.2025

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE PËR
ZËVENDËSMINISTRIN PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenet 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 15, të



ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Znj. Miriam Shyti, zëvendësministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të politikave për diasporën dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse, për këto politika;

b) Përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të platformës së diplomacisë ekonomike dhe kulturore;

c) Zhvillimin e konsultimeve politike dypalëshe, në lidhje me çështje të diasporës, diplomacisë ekonomike dhe kulturore, ku kërkohet nivel zëvendësministri;

d) Ndjekjen e aplikimit të metodave inovative dhe diplomacisë digjitale në aktivitetin e Shërbimit të Jashtëm;

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjesisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 922, datë 28.10.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë

